- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkojnë më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkojnë në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do të lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shpëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëshmipërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Obligimet e kontraktuesit	8	Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave që i jep autoriteti kontraktues. Me kërkesën e zyrtareve të AK, kontraktuesi është i obliguar që ti siguroj të gjitha atestete për produktet e kerkuarta.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së ofertës në afat prej 180 diteve</i> Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% nga vlera e me garancion bankar nga një bankë e licencuar ose kompani sigurimesh e licencuar nga BQ e Kosovës për një periudhë garantuuese prej së paku 180 ditëve, duke filluar nga data e fillimit të punimeve. - Pas përfundimit të punimeve dhe pranimi të tyre nga Komisioni i Autorizuar, Kontraktuesi duhet të depozitojë Sigurimin e përmbushjes në vlerën 10% nga vlera e punimeve të realizuara si garancë për kualitetin dhe cilësinë e punëve në afatin prej 5 viteve nga data e pranimi të punimeve nga Organi kompetent
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro

		për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga data caktuar ne planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 150 dite pas nënshkrimit te kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës me vendim nga ZKA dhe i cili do të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.
Pagesat	24	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës por jo me pak se 50000 euro. Situacioni i fundit duhet te jete jo me pak 10% e vleres se kontrates me konstatim nga menagjeri i kontrates.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.

		Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar ose nga kompania e sigurimeve“me kërkesë”. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve - <u>5 vite</u>
Shkaqet për kompensim	30.1	-
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Paramasa dhe parallogaria e objektit: Bibliotekë, Lagjja "Kodra e Trimave", Prishtinë

A					
ARKITEKTURA					
1 Punët paraprake					
nr.	Përshkrimi i pozicionit	njësia	sasia	çmimi njësi	Shuma
1.1	Patrimi i terenit për tu mundësuar piketimin e themeleve të objektit	m2	900.00	0.50	450.00
1.2	Rethimi i punishtes me lartësi minimale 2m konform planit për organizimin e punishtes rregullave për siguri në punishte.	komplet	1.00	500.00	500.00
1.3	Vendosja e tabelës informacioneve dim. 150x250 cm së rreth projektit konform përmbajtjes të përcaktuar me ligjet në fuqi.	copë	1.00	250.00	250.00
1.4	Piketimi digjital i themeleve të objektit në teren	m2	864.00	0.10	86.40
1.5	Vendosja e kontejnerit për nevojat e stafit mbikqyrës dhe menagjeriale me sipërfaqe minimale 12 m2.	copë	1.00	250.00	250.00
GJITHSEJTË Punët paraprake					1,536.40
2 Punët e dheut					
nr.	Përshkrimi i pozicionit	njësia	sasia	çmimi njësi	Shuma
2.1	Gërmimi i terenit me makineri deri në nivelin e shtresës së fundme të themel-pllakës së podrumit. Në pozicion është përfshirë edhe pjesa e gërmimit shtesë në pjesën e zgjerimit të shputave të shtyllave. Pozicioni përfshinë edhe transportin e dheut deri tek deponia e përshtatshme konform ligjit.	m3	5,350.00	0.80	4,280.00
2.2	Gërmimi i terenit me makineri deri në në pjesën shkallëve të jashtme të cilat shpiejn në dhomën teknike. Pozicioni përfshinë edhe transportin e dheut deri tek deponia e përshtatshme konform ligjit.	m3	85.20	1.50	127.80
2.3	Rrafshimi dhe nivelimi i shtresës së tokës së gërmuar si parakusht për hedhjen e shtresës së zhavorit. Rrafshi duhet të bëhet saktësisht konform nivelit të shtresës së fundit të themeleve në mënyrë që të mos ketë humje gjatë vendosjes së zhavorit.	m2	986.00	0.50	493.00
2.4	Furnizimi dhe punimi i shtresës mbushëse të themelit pllakë me zhavor (dim. e granulacionit 0-60mm) në trashësi prej 2*25cm dhe ngjeshja e tijë duhet arrijë vlerat 6000 kN/m2 deri në vlerat koeficientit të paraparë simbas elaboratit gjeomekanik, pjesë e projekt-dokumentacionit teknik	m3	493.00	5.00	2,465.00
2.5	Furnizimi dhe punimi i drenazhes (dim. e granulacionit 31-63mm) përgjatë gjithë perimetrit gjatësor të mureve të jashtme të podrumit me qëllim të drenazhimit të ujërave nëntoksor dhe sipërfaqësor deri tek niveli i gypit për drenazhim në nivelin e fundëm të tabanit të themel-pllakës	m3	245.00	7.00	1,715.00
					9,080.80



3 Punët e betonimit					
nr.	Përshkrimi i pozicionit	njësia	sasia	çmimi njësi	Shuma
3.1	Furnizimi me material dhe betonimi i shtresë rrafshuese nën pllakën e themelit me trashësi prej 5cm, me beton të klasës C-16/20.	m3	49.50	40.00	1,980.00
3.2	Furnizimi me material dhe betonimi i shtresë rrafshuese për mbulimin e hidroizolimit me trashësi prej 5cm, me beton të klasës C-16/20.	m3	49.50	40.00	1,980.00
3.2	Përgaditja për betonim dhe betonimi i themel-pllakës në trashësi prej 40cm, shputat me thellesi 80cm dhe gropës së ashensorit sipas detajeve teknike me beton të klasës C-30/37. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	350.00	50.00	17,500.00
3.3	Përgaditja për betonim dhe betonimi i mureve të jashtme perimetrale të përdhësës me lartësi h=4.0 m, me beton të klasës C-30/37. Përgaditja e kallëpëve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpëve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e mureve të betonit do të jetë pjesë e dukshme e fasadës "Natur beton". Në pjesën e mbarimit të nivelit të sipërm të murit të përdhësës (tek niveli i pllakës së meskatit) të vendoset llajsne druri horizontale me profil trekëndor në mënyrë që në vijën e ndërprejes së betonimit të murit të përdhësës dhe fillimit të betonimit të mëpastajm të murit të katit, të mbetet vijë e pastër e drejtë meqë edhe kjo do të mbetet në dukje në pjesën e fasadës. Muret perimetrale përbëhen nga dy shtresa betoni (25 cm shtresa e brendëshme dhe 10cm shtresa e jashtme) me mbushje termoizoluese në mes prej 10cm. Betonit gjatë përzjerjes duhet ti shtohen edhe aditiv të cilët e bëjnë atë joujëleshues. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	132.00	58.00	7,656.00
3.4	Përgaditja për betonim dhe betonimi i mureve të jashtme perimetrale të katit me lartësi h=4.0m, me beton të markës 30. Përgaditja e kallëpëve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpëve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e mureve të betonit do të jetë pjesë e dukshme e fasadës "Natur beton". Në pjesën e mbarimit të nivelit të sipërm të murit të katit (tek niveli i pllakës së kulmit të rrafshët) të vendoset llajsne druri horizontale me profil trekëndor në mënyrë që në vijën e ndërprejes së betonimit të murit të katit dhe fillimit të betonimit të mëpastajm të murit të atikës, të mbetet vijë e pastër e drejtë meqë edhe kjo do të mbetet në dukje në pjesën e fasadës. Muret perimetrale përbëhen nga dy shtresa betoni (25 cm shtresa e brendëshme dhe 10cm shtresa e jashtme) me mbushje termoizoluese në mes prej 10cm. Betonit gjatë përzjerjes duhet ti shtohen edhe aditiv të cilët e bëjnë atë joujëleshues. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	98.60	58.00	5,718.80
3.5	Përgaditja për betonim dhe betonimi i shtyllave vertikale përdhësës 60x60 cm, me beton të klasës C-35/45. Përgaditja e kallëpëve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpëve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e shtyllave të betonit do të jetë pjesë e dukshme e enterierit "Natur beton". Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	28.50	60.00	1,710.00
3.6	Përgaditja për betonim dhe betonimi i shtyllave vertikale katit 60x60 cm, me beton të klasës C-35/45. Përgaditja e kallëpëve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpëve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e shtyllave të betonit do të jetë pjesë e dukshme e enterierit "Natur beton". Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	28.50	60.00	1,710.00

3.7	Përgaditja për betonim dhe betonimi i shtyllave vertikale me dim 60x60 cm, me beton të klases C-35/45, në pjesën perimetrale të objektit të cilat shkojnë pandërprerë në lartësinë e dy dykateve. Betonimi i tyre të bëhet vetëm me një ndërprerje në nivelin e 4 metrave. Përgaditja e kallëpeve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpeve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e shtyllavetë betonit do të jetë pjesë e dukshme e fasadës "Natur beton". Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	31.50	60.00	1,890.00
3.8	Përgaditja për betonim dhe betonimi i trajeve horizontal primar në nivelin e kulmit të rrafshët dim. 70x60cm me beton të klases C-30/37. Vërejtje: Përgaditja e kallëpeve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e shtyllavetë betonit do të jetë pjesë e dukshme e enterierit "Natur beton". Në koturet e poshtme të treut të vendosen llajsne horizontale me profil trekëndor në mënyrë që vijat finale të pjesës së poshtme të traut të mbesin sa më të padëmtuara gjatë procesit të heqjes së kallëpeve. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	135.60	50.00	6,780.00
3.8	Përgaditja për betonim dhe betonimi i trajeve horizontal primar në nivelin e meskatit dim. 60x60cm, me beton të klases C-30/37. Vërejtje: Përgaditja e kallëpeve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e shtyllavetë betonit do të jetë pjesë e dukshme e enterierit "Natur beton". Në koturet e poshtme të treut të vendosen llajsne horizontale me profil trekëndor në mënyrë që vijat finale të pjesës së poshtme të traut të mbesin sa më të padëmtuara gjatë procesit të heqjes së kallëpeve. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	74.50	50.00	3,725.00
3.9	Përgaditja për betonim dhe betonimi i kontruksionit meskatësh (pllakave B/A) d= 22cm, me beton të klases C-30/37. Përgaditja e kallëpeve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	138.00	50.00	6,900.00
3.1	Përgaditja për betonim dhe betonimi i mureve të atkës me lartësi h=1.4 m, me beton të klases C-30/37. Përgaditja e kallëpeve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Vërejtje: Përgaditja e kallëpeve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e mureve të betonit do të jetë pjesë e dukshme e fasadës "Natur beton". Në pjesën e mbarimit të nivelit të sipërm të traut (tek niveli i pllakës së kulmit të rrafshët) të vendoset llajsne druri horizontale me profil trekëndor në mënyrë që në vijën e ndërprejes së betonimit të traut të betonuar më herët dhe fillimit të betonimit të të murit të atikës, të mbetet vijë e pastër e drejtë meqë edhe kjo do të mbetet në dukje në pjesën e fasadës. Muret perimetrale përbëhen nga dy shtresa betoni (20 cm shtresa e brendëshme dhe 10cm shtresa e jashtme) me mbushje termoizoluese në mes prej 10cm. Betonit gjatë përzierjes duhet ti shtohen edhe aditiv të cilët e bëjnë atë joulëlshues. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	95.00	50.00	4,750.00



3.11	Përgaditja për betonim dhe betonimi i pllakës së fundit të tipit kaseton, në nivelin e kulmit të rrafshët. Trashësia e pllakës është d=10cm ndërsa trajet sekondar dimensionet 70x15 cm, me beton të klases C-30/37.. Vërejtje: Përgaditja e kallëpeve duhet të bëhet me element dhe lidhës metalik të përdorur për herë të parë, të radhitur konform planit të kallëpimit duke ditur se tekstura e pllakës kaseton do të jetë pjesë e dukshme e enterierit "Natur beton". Në koturet e poshtme të secilit tra sekondar të vendosen llajsne horizontale me profil trekëndor në mënyrë që vijat finale të pjesës së poshtme të traut të mbesin sa më të padëmtuara gjatë procesit të heqjes së kallëpeve. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	172.50	50.00	8,625.00
3.12	Përgaditja për betonim dhe betonimi i shkallëve të jashtme dhe të brendshme të objektit me beton të klases C-30/37. Shkallt duhen punuar saktësisht me dimensionet e projektuar (lartësi / shkelëse) pasi që shtresa finale e tyre do të jetë prej Epoksidi pa ndonjë parashtrës tjetër rrafshuese. Në pjesët e kontureve ku puqiten lartësia e shkallës me shkelësen, të vendosen llajsne horizontale prej druri me profil tërthor trekëndor në mënyrë që konturet e shkallëve të mbesin sa më të pastra gjatë procesit të përpunimit të tyre.	m3	35.60	50.00	1,780.00
3.13	Përgaditja për betonim dhe betonimi i kafazit të ashensorit, me beton të klases C-30/37. Përgaditja e kallëpëve për betonim bëhet konform dimensioneve të parapara me projektin e konstruksionit. Gjatë betonimit obligativisht të merren mostrat për kontrollimin e cilësisë së betonit në kushte laboratorike.	m3	32.40	50.00	1,620.00
3.14	Furnizimi me material, punimi i estrihut me trashësi min 5 cm me përforcim të fibrave (fiba qelqi). Në çmim të përfshihet edhe shtresa termoizoluese me trashësi 2+2 cm, folje pvc për mbulimin e sipërfaqes termoizoluese para vendosjes së shtresave finale në dyshemenë e katit përdhës.	m2	780.00	5.00	3,900.00
3.15	Furnizimi me material, punimi i estrihut me trashësi min 5 cm me përforcim të fibrave (fiba qelqi). Në çmim të përfshihet edhe shtresa termoizoluese me trashësi 2+2 cm, folje pvc për mbulimin e sipërfaqes termoizoluese para vendosjes së shtresave finale të dyshemesë së meskatit.	m2	448.00	5.00	2,240.00
GJITHSEJTE Punët e betonimit					80,464.80



4		Punët e armimit			
nr.	Përshkrimi i pozicionit	njësia	sasia	çmimi njësi	Shuma
4.1	Furnizimi, përpunimi i armaturës dhe vendosja në vendin e specifikuar sipas detajeve të projektit dhe përshkrimit teknik në të gjitha pozicionet e parapara me projekt.	kg	158,650.00	0.45	71,392.50
GJITHSEJTË Punët e armimit					71,392.50
5		Punët e hidroizolimit			
nr.	Përshkrimi i pozicionit	njësia	sasia	çmimi njësi	Shuma
5.1	Izolimi i i themel-pllakës me material hidroizolues me rrollne me bazë bituliti i ngjitur me shkrije, në dy shtresa të kryqësuar. Para vendosjes së shtresave hidroizluese e gjithë sipërfaqja parapakisht të lyhet me bitulit në gjendje të lëngët.	m2	1,080.00	4.00	4,320.00
